



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit
Regulativni Autoritet Telekomunikacije
Telecommunication Regulatory Authority



Në bazë të nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit për Telekomunikacion nr.2002/7, të ndryshuar me Ligjin nr.03/L-085 dhe nenit 5 të Rregullores për Planin e Numeracionit për Rrjetat e Telekomunikacionit në Kosovë nr.153/07 të nxjerr nga ART, Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit, ART do të caktoj tarifa për numra dhe blloqe numrash, andaj lidhur me këtë merret ky,

VENDIM

I Aprovohen tarifat për numeracion si me poshtë:

Tarifimi	Gjeografik	Mobil	Carrier (pre selection)	Free phone	Premium rate	Shared cost	Personal numbers
Alokimi	0	0	0	0	0	0	0
Përdorimi	0.15	0.15	1300	0	80	20	0.20

II Tarifimi është përcaktuar në bazë të shërbimeve.

III Tarifat janë caktuar për numra dhe vlera e tyre është në euro.

IV Tarifimi është përcaktuar për përdorim e numrave dhe do të bëhet në bazë vjetore.

V Tarfimi për përdorim të numrave do të filloj nga 01.01.2009.

Arsyetim

Sipas Ligjit për Telekomunikacion dhe Rregullores për Planin e Numeracionit për Rrjetat e Telekomunikacionit në Kosovë, ART do të vendos tarifa për numra dhe blloqe numerash.

Për të përcaktuar këto tarifa ART ka marrë parasysh rekomandime dhe praktika të ndryshme evropiane.

3

Sî dokumente bazë janë marrë rekomandimet e CEPT-ECC. Njëkohësisht është analizuar baza e të dhënave të ITU për tarifimin e numeracionit si dhe rekomandimet e tyre e po ashtu janë shqyrtuar dhe analizuar të gjitha praktikat e shteteve evropiane.

Gjatë përcaktimit të tarifave është vendosur që të mos ketë tarifim për alokim të numrave por vetëm për përdorim të tyre.

Tarifimi është përcaktuar në bazë të shërbimëve të ofruara. Kjo tarifë është përcaktuar për numra dhe vlera e saj është e shprehur në euro, tarifimi për të gjithë shfrytëzuesit e numrave do të filloj nga 01.01.2009 dhe ky tarifim bëhet njëherë në vit.

Prishtinë
01.12. 2008

Anton Berisha
Kryetari i Bordit – Drejtor Ekzekutiv

